



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1125/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - thyerje e heshtjes zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN pjesërisht të bazuara ankesat e evidentuara me numra Anr.1125/2021 dhe Anr.1133/2021 të datës 14.11.2021, të paraqitura nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ashtu që subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 5,100.00 (pesëmijë e njëqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - thyerje e heshtjes zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në Komunën e Podujevës.

II. DETYROHET Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

III. Refuzohet pjesa e ankesës e paraqitur nga Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet gjorbë Subjektit Politik LVV, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - thyerje e heshtjes zgjedhore në lagjen “Kodrën e Trimave” në Prishtinë dhe në zyrat e LVV në Komunën e Gjakovës.

Ar sy e t i m

PZAP, ka pranuar ankesat Anr.1125/2021 dhe Anr.1133/2021 të datës 14.11.2021 nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës në të cilat pretendon se me datë 14 nëntor 2021 aktivistët e LDK-së rreth orës 08:00 dhe 15:00 kanë vërejtur se kryeministri i Kosovës Albin Kurti, kandidati për kryetar komune të Podujevës nga LVV- Shpejtim Bulliqi, kandidatja për kryetar komune të Gjakovës- Mimoza Kusari kanë thyer heshtjen zgjedhore në qytetin e Podujevës ashtu që kanë parakaluar në ecje me plot aktivist të LVV-së në sheshin këtij qyteti dhe kanë mbajtur takim e tubim më aktivistë e qytetar në kafene “Boem” si dhe në qytetin e Gjakovës duke parakaluar në ecje me aktivistë të LVV-së në Qarshi të Madhe duke mbajtur takim në zyre të LVV-së në Gjakovë. Po ashtu veprime të cilat kanë thyer heshtjen zgjedhore kryeministri Albin Kurti dhe kandidati i LVV-së Eman Rrahmani me aktivistë të tjerë kanë bërë edhe në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë duke u mbledhur dhe duke bërë kryeministri bërë thirrje për votim në ditën e zgjedhjeve. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe janë sanksionuara me dispozitën ligjore të nenit 36 par.1 pika b) të LZP-së, dispozita të zbatueshme në kuptim të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

PZAP, me datë 14.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje duke i kërkuar që të përgjigjet deri me datë 15.11.2021, në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 14.11.2021 Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje i kundërshton pretendimet e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke theksuar se provat e paraqitura nga Subjekti Politik LDK nuk dëshmojnë për asnjë çast se Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti ka thyer heshtjen zgjedhore në çfarëdo forme vetëm se ka ecur sheshit dhe pastaj është ulur për të pirë kafe në një lokal. Pretendimi tjetër i ankuesit ku theksohet se Kryeministri i Republikës së Kosovës ka mbajtur takim më aktivistë dhe qytetar në një kafene të caktuar në Podujevë dhe në zyra të LVV-së në Gjakovë është sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë është i paqëndrueshëm dhe i rrëzueshëm tërësisht sepse nuk ka pasur asnjë tubim siç pretendon paraqitësi i ankesës pasi që subjekti politik LVV nuk ka thirrur as nuk ka organizuar ndonjë tubim gjatë heshtjes zgjedhore prandaj edhe kualifikimi i pretendimeve të tilla është i paqëndrueshëm. Pretendimi tjetër se Kryeministri

Albin Kurti ka thyer heshtjen zgjedhore duke mbajtur takim në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë po ashtu parashtuesi i përgjigjes në ankesë i vlerëson si të paqëndrueshme pasi që sipas të njëjtit në asnjë mënyrë nuk dëshmohet pretendimi i ankuesit nga provat e paraqitura krahas ankesës dhe se nga fotografitë e ankuesit nuk vërehet askund Kryeministri Kurti e as nuk vërehet ndonjë tubim siç pretendohet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve në ankesat Anr.1125/2021 dhe Anr.1133/21 të datës 14.11.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta dhe të gjitha ankesat janë paraqitur nga subjekti politik LDK, po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se:

Lidhur me pretendimet në përgjigje në ankesë të Subjektit LVV se këto veprime në formë të ecjes nëpër komuna dhe qëndrimi ulur në një kafiteri nuk sanksionohen më asnjë dispozitiv të LZP-së dhe përkundër kësaj këto veprime si të tilla garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që me këto prova nuk justifikohen veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore e nga fotot e ofruara si provë nga ana e parashtuesit të ankesës shihet qartë se me datë 14.11.2021 Kryeministri Albin Kurti së bashku me kandidatët për deputet të cekur si në ankesë dhe me aktivistë tjerë të këtij subjekti kanë parakaluar në sheshin e qytetit të Podujevës me kandidatin për kryetar të Komunës së Podujevës.

Të gjitha këto veprime janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore siç përcaktohet edhe me nenin 36 par.1 të LZP-së “ *njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si....bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*”. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim ndryshe në vendosjen e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori parasysh edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara, kjo ka pasur efekt edhe në vendosjen sa i përket lartësisë së gjobës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -III-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për thyerjen e heshtjes zgjedhore dhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se Kryeministri Albin Kurti ka thyer heshtjen zgjedhore duke mbajtur takim në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë si dhe në zyrat e Subjektit Politik LVV në Gjakovë pasi që nga dëshmitë e ofruara si provë nuk mund të vërtetohet se në Gjakovë ka qenë kryeministri sepse nuk shihet në video i njëjti, ndërsa në

kodrën e Trimave edhe pse shihet kryeministri në lokacionin në falë nuk mund të arrihet në konkludim se ka qenë duke bërë fushatë, pavarësisht faktit të prezencës së tij fizike.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1125/2021 më datën 15.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.